



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012
Nr. ref.:MP334/12

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

Rastin Nr. KO131/12

Parashtrues

Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për
Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më
13 dhjetor 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dr. Shaip Muja, Nait Hasani, Ramiz Lladrovci, Petar Miletić, Azem Syla, Time Kadrijaj, Xhevdet Neziraj, Kymete Bajraktari, Kurtan Kajtazi, Hydajet Hyseni, Sasha Milosavlević dhe Sala Berisha.

Ligji i kontestuar

2. Ligji i kontestuar është Ligji për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 13 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit të kontestuar.
4. Më tej, parashtruesi ka kërkuar aplikimin e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe neni 38 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 dhjetor 2012, nëpërmjet postës, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
7. Bashkëlidhur me kërkesën, parashtruesi ka dërguar në Gjykatë edhe kopjen e Ligjit të Punës (Nr. 03/L-212), të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Nr. 02/L-133) dhe të Ligjit Kundër Diskriminimit, për të cilat parashtruesi thekson se janë relevante për shqyrtimin e kërkesës së parashtruar dhe janë në lidhmëni me këtë kërkesë.
8. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata, nëpërmjet postës zyrtare, mori një kopje të Ligjit për Shëndetësinë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
9. Kryetari i Gjykatës e caktoi Zëvendëskryetarin e Gjykatës, dr. Ivan Čukalović Gjuqtar raportues, si dhe emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët: Altay Suroy, Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e njoftoi Kuvendin e Republikës dhe parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 25 dhjetor 2012, në një seancë të mbyllur, Kolegji shqyrtues shqyrtoi kërkesën dhe njëzëri i propozoi Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës dhe për pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 13 dhjetor 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) miratoi Ligjin për Shëndetësinë me 43 (dyzet e tri) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër dhe 3 (tri) abstenime.
13. Më 27 nëntor 2012, para se Kuvendi ta miratonte Ligjin në seancë plenare, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Kosovës kishte dërguar **Rekomandim (04/3239/I-125)** dhe, në pikën I, kishte marrë qëndrimin që Projektligji për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, nuk mund të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm, duke i sugjeruar Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që t'i rishikojë amendamentet 1, 3, 12, 34, 48, 49, 50, 51 dhe 52.

14. Më 17 dhjetor 2012, Federata Sindikale e Shëndetësisë e Kosovës, i kishte dërguar Avokatit të Popullit kërkesë për inicimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 41 të Ligjit për Shëndetësinë, duke pretenduar se ky nen bie ndesh me Kushtetutën.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për Shëndetësinë përmban dispozita që punëtorët shëndetësorë i vënë në pozita të pabarabarta me të punësuarit në institucione të tjera publike dhe, rrjedhimisht, edhe në pozitë të mos jenë të barabartë para ligjit me punonjësit e tjerë të institucioneve publike.
16. Parashtruesi ka kontestuar në veçanti nenet pasuese të Ligjit, që kanë këtë përmbajtje:

Neni 18

Kujdesi parësor shëndetësor

1. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet në pajtim me politikat, planet, dhe standardet e përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
2. Kujdesi parësor shëndetësor përfshin:
 - 2.1. Promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin, dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
 - 2.2. Mbrojtjen parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme, dhe të larta në territorin e Komunës.
 - 2.3. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksinë, vaksino-profilaksinë, dhe kimio-profilaksinë në pajtim me ligjin, si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësor të popullatës;
 - 2.4. Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;
 - 2.5. Diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e tuberkulozës;
 - 2.6. Organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore si pjesë e sistemit unik të shërbimeve në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor;
 - 2.7. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjar;
 - 2.8. Shërbimet e shëndetit mendor.
3. Komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.
4. Komunat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor.
5. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës së shërbimeve të mjekësisë familjare, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

6. Përbërja e ekipit të mjekësisë familjare përcaktohet me aktin nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni.
7. Çdo qytetar dhe banor me vështirësi shëndetësore është i obliguar të lajmërohet fillimisht tek mjeku familjar, me përjashtim të rasteve emergjente.
8. Prej çdo qytetari dhe banori do të kërkohet të përcaktohet për një mjek familjar.
9. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën ku jeton, brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, dhe ka të drejtë ta ndërrojë atë.
10. Profesionistët në kujdesin parësor shëndetësor do të bashkëpunojnë me profesionistët shëndetësorë në nivelin dytësor dhe tretësor, në pajtim me këtë ligj.
11. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektorial me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare.
12. Standardet e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare, përcaktohen me aktin nën-ligjor nga paragrafi 1. i këtij neni.
13. Me qëllim të mbështetjes së shërbimeve të mjekësisë familjare, Ministria mbikëqyrë dhe rregullon shërbimet e integruara të kujdesit parësor shëndetësor, në pajtim me këtë ligj.

Neni 19 **Kujdesi dytësor shëndetësor**

1. Kujdesi dytësor shëndetësor përfshin: shërbimet spitalore, shërbimet jashtëspitalore: diagnostiko, terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent, si dhe shërbimet e shëndetësisë publike.
2. Organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria.

Neni 41 **Parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Profesionisti shëndetësor i punësuar në sektorin publik shëndetësor, me orar të plotë ose të pjesërishtë të punës, nuk ka të drejtë të punojë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.
2. Është e ndaluar që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor tek institucionet private të kujdesit shëndetësor për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.
3. Ndalohet rreptësisht çfarëdo shpërblimi formal ose joformal, financiar ose i llojit tjetër i profesionistit shëndetësor përfshirë shpërblimin për referimin e qytetarit ose banorit nga sektori publik në sektorin privat të shëndetësisë, dhe marrëdhëniet profitabile me industrinë farmaceutike.

4. Shkelësit e dispozitave të këtij neni do të jenë subjekt i dënimeve ose veprimeve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe aktin e veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
5. Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë që t'ua mundësojnë profesionistëve shëndetësorë të punësuar në to, që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vet institucionit publik shëndetësor.
6. Veprimtaria private shëndetësore nga paragrafi 5 i këtij neni do të zbatohet në bazë të aktit të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 60 **Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor**

1. Institucionet shëndetësore dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari shëndetësore, janë të obliguara, që për çdo pacient të dokumentojnë shpenzimet si edhe llojin, vëllimin, cilësinë dhe çmimin e shërbimeve.
2. Institucionet shëndetësore dhe organizatat që marrin fonde publike për zbatimin e kujdesit shëndetësor, janë të detyruara të mbajnë llogaritë dhe evidencat në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe të sigurojnë informata të nevojshme për organet e autorizuar.
17. Parashtruesi thekson se Ligji për Shëndetësinë, i miratuar nga Kuvendi, është në kundërshtim me konventat evropiane që, sipas nenit 22 të Kushtetutës, janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë, pa specifikuar se cilat konventa.
18. Më tej, parashtruesi ka theksuar se dispozitat e Ligjit për Shëndetësi, sidomos dispozitat e nenit 18 dhe 19, bien në kolizion të hapur me dispozita të ligjeve të tjera, si Ligji për Partneritetin Publiko-Privat dhe se edhe vetë ligji ka dispozita kundërthënëse në tekstin e tij.
19. Neni 41 i Ligjit për Shëndetësi, sipas parashtruesit, cenon nenin 49 të Kushtetutës, sepse ua ndalon punëtorëve shëndetësorë të drejtën e garantuar për punë dhe për zgjedhje të profesionit.
20. Përfundimisht, neni 60 i këtij Ligji, sipas parashtruesit të kërkesës, është në kolizion të hapur me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, sepse institucionet shëndetësore i përkufizon si institucione joprofitabile.

Vlerësimi për masë përkohshme

21. Kur vendos përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 116.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme”.

22. Gjykata më tej merr parasysh nenin 27, pika 1 dhe pika 2, të Ligjit Për Gjykatën Kushtetuese (Nr. 03L-121), i cili përcakton:

1. *Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masë të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i*

procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. *Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.*
23. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtuese, gjithashtu, specifikon kushtet për aplikimin e masës së përkohshme dhe, në këtë drejtim, ka paraparë se, në mënyrë që Gjykata të mund të lejojë masën e përkohshme në përputhje me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të gjejë që:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për papranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme, dhe;

(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

24. Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga 12 deputetë të Kuvendit të Kosovës, Gjykata Kushtuese gjen që:

Neni 51. **[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]** i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka paraparë se:

1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.
25. Bazuar në përkufizimet e mësipërme kushtetuese, Gjykata konstaton se mbrojtja shëndetësore është “e drejtë e njeriut, e garantuar me Kushtetutë” dhe është pjesë e Kapitullit II të Kushtetutës, e cila i referohet të drejtave të njeriut.
26. Gjykata më tej thekson se, në përputhje me nenin 21, pika 1, të Kushtetutës, “*të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës*”.
27. Duke qenë kategori kushtetuese, “Mbrojtja shëndetësore” pa dyshim se është në interesin publik të qytetarëve të Kosovës, duke qenë njëkohësisht edhe e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacenueshme e njeriut për secilin individ.
28. Me qëllim të evitimit të cenimit të mundshëm të interesit publik dhe të së drejtës së garantuar me Kushtetutë për mbrojtje shëndetësore, Gjykata konsideron se ka arsye për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.
29. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh faktin se **Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]** i Kushtetutës qartazi parasheh:
1. E drejta e punës garantohet.
 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.
30. Për të evituar mundësinë e cenimit edhe të kësaj të drejte të garantuar me Kushtetutë, Gjykata rithekson nevojën për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.

31. Prandaj, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, miratohet kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit, më 24 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TË LEJOJË masën e përkohshme;
- II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013, prej ditës së miratimit të këtij Vendimi;
- III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetor 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;
- IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve; dhe
- V. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 29 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

